

**VENDIM**  
**Nr. 707, datë 26.8.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 107, DATË 10.2.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 6.1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-së), sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar;

ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti."

2. Pas pikës 6.8 shtohen pikat 6.9, 6.10 dhe 6.11, me këtë përmbajtje:

"6.9. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore të arsimit bazë mbulohet në masën 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

a) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimat të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.

Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit në përputhje me vendimin nr. 582, datë 27.7.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit".

b) Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit /vuajtjes së dënimit.

c) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.

ç) Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.

d) Për çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.

6.10. Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6.11. Për tekstet shkollore të fëmijëve nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në drejtoritë arsimore

rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.”.

II. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**